



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

Rruga Ukshin Kovaçica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Nr. Prot. 1247  
Dt 30.09.2020

Bazuar në vendimin e Senatit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, nr prot. 1246, dt. 30.09.2020, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” shpall këtë:

**Njoftim**

1. Të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në konkursin për pranimin e studentëve të rinj në UMIB, për vitin akademik 2020/2021, të cilët gjatë aplikimit nuk kanë poseduar letërnjoftim, për shkak të problemeve në MPB, por kanë poseduar vetëm fletëaplikacionin për letërnjoftim të lëshuar nga institucioni kompetent, do të fotografohen me rastin e hyrjes në provimin pranues.
2. Fotografimi i studentëve do të bëhet nga një person i autorizuar nga njësia akademike.
3. Fotografimi do të bëhet në pamjen ballore të kandidatit, së bashku me fletëaplikacionin për letërnjoftim të lëshuar nga institucioni kompetent.
4. Obligohet njësia përkatëse akademike që të autorizojë një person zyrtar për të fotografuar kandidatët nga pika 1.
5. Obligohet Komisioni për pranim të studentëve i njësisë përkatëse akademike që të mbikqyrë dhe udhëheqë mbarëvajtjen e këtij procesi.

